



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPKI
 Nr. Prot. 06-02/3103/22
 Br. Prot. 02
 Data 28-07-2022
 Nr. pages 02



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, nenit 5 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.07.2022, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-2626/22, për zyrtarin e lartë publikë znj. Myrvete Salihi, anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të mundshëm interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë znj. Myrvete Salihi, anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit sipas raportimit (nga jashtë) e ka hapur rastin për situatë të mundshme të konfliktit të interesit, sipas të cilit znj. Salihi duke qenë anëtarë e Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, njëkohësisht mbante edhe funksionin e drejtorit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Pejë.

Për t'i vërtetuar pretendimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka verifikuar Formularin e Deklarimit të Pasurisë (DRV10531/2022/1) të zyrtares Salihi, në të cilin e njëjta ka deklaruar se i mban të dy pozitat e përshkruara si më sipër.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit përmes shkresës (AKK-DPKI-06-02/2772/22) e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Gjithashtu, Agjencia kundër Korrupsionit ka kontaktuar me znj. Salihi, dhe me kërkesën e saj për sqarim të situatës është caktuar edhe takim në Agjenci.



Në takimin e mbajtur, zyrtari i lartë është njoftuar lidhur me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit dhe me faktet që posedon Agjencia përkitazi me kufizimet sa i përket mbajtjes së njëkohshme të dy pozitave, dhe atë duke ju referuar Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, respektivisht, nenit 65 paragrafi 2, në të cilin përcaktohet se:

“Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të kuvendit të Republikës së Kosovës apo kuvendit të komunës të komunës ku ata punojnë.”

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.


Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-02/2772-1/22) me dokumentet përcjellëse, në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.4. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni publik.

Me veprimet e ndërmarra nga znj. Salihi, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll BULESHKAJ
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit